



KOMUNA E PRISHTINËS

RAPORT MUJOR

Drejtoria	Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Periudha raportuese	Prill 2018
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Lindita Hajdari - Salihi

1. PËRMBLEDHJE - Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues

Sektori i kulturës, rinisë dhe sportit

- Gjatë muajit raportues janë realizuar shumë takime të planifikuara dhe të paplanifikuara me partnerë, palë të jashtme dhe kolegë nga Drejtoria dhe Komuna. Drejtoria e Kulturës, si dhe institucionet varëse, kanë realizuar planin operativ të punës, si dhe angazhime tjera sipas nevojës.

2. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA - Listoni aktivitetet për muajin raportues, të parapara sipas planprogramit të Komunës për drejtorinë tuaj.

Sektori i kulturës, rinisë dhe sportit:

- Shqyrtimi i kërkesave për dhënie të pëlqimeve për shfrytëzim të hapësirës;
- Realizimi i planit operativ të punës dhe angazhime të tjera sipas nevojës së DKRS-së;
- Pranimi, shqyrtimi dhe përfundimi i lëndëve ditore;
- Kontrollimi i raporteve narrative dhe financiare për projektet e subvencionuara;
- Përgatitja e deklaratës së disponueshmërisë për tenderin "Organizime dhe manifestime kulturore dhe sportive";
- Vazhdimi i punës së grupit punues për narrativen e qytetit të Prishtinës;
- Parapërgatitjet rreth marrëveshjes së mirëkuptimit mes Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe organizatës "Q'ART";
- Parapërgatitjet rreth memorandumit të mirëkuptimit për bashkëpunim të ndërsjellë mes Drejtorisë Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Fondacioni Trashëgimia Kulturore pa Kufij (CHwB);

- Takimet e komisionit për ndarjen e subvencioneve nga fusha e kulturës për manifestime, organizime, festivale dhe ekspozita.

Arkivi Komunal i Prishtinës:

- Klasifikimi dhe rregullimi i lëndës arkivore nga njësia e organizative “Banka dhe Financa”, vitet 1960 - 1999.

Biblioteka “Hivzi Sulejmani”:

- Angazhimi i një grupi të punonjësve të bibliotekës, tri praktikanteve dhe të rinjve nga Shërbimi sprovues për futjen në katalog të librave në retrospektivë dhe përpunimi fizik i tyre, me qëllim të funksionalizimit të Modullit të huazimit sipas planifikimit, me qëllim që të fillojë brenda këtij viti;
- Përpunimi fizik i materialeve bibliotekare;
- Klasifikimi dhe katalogimi i librit;
- Regjistrimi i anëtarëve të rinj;
- Huazimi i librit;
- Mirëmbajtja e ueb-faqes së bibliotekës;
- Përgatitja e raporteve mujore dhe vjetore;
- Shënimi i Ditës ndërkombëtare të librit për fëmijë, më 2 prill;
- Shënimi i Ditës botërore të librit dhe të drejtave të autorit, më 23 prill, ku do të ndahen edhe mirënjohe për lexuesit e dalluar të vitit 2017;
- Mbikëqyrja dhe angazhimi i të rinjve nga Shërbimi sprovues me punë të detyrueshme në bibliotekë (përpunimi fizik i librit);
- Trajnimi dhe mbikëqyrja e tri praktikanteve në punët profesionale të veprimtarisë bibliotekare;
- Vizita të rregullta të institucioneve shkollore dhe parashkollore.

Teatri i qytetit të Prishtinës “Dodona”:

- Planifikohen 8 shfaqje të rregullta në skenën e teatrit të kukullave, çdo të shtunë, në orën 12:00 dhe 13:00;
- Planifikohen 3 shfaqje të organizuara në skenën e Teatrit të kukullave;
- Do të realizohen repriza të shfaqjes “Ëndrra e Hamletit”, “ Princi i vogël”, “Kësulëkuqja”, “Mustaqoshi larosh”, “ Topi Hopi”, “ Goni trazovaçi”.

- Në kuadër të aktiviteteve promovuese, do të realizohet një takim me 50 fëmijë nga Prishtina, Mitrovica dhe Ferizaj, të cilëve Valdet Rama do t'ua mbajë një ligjërate shkollore për teatrin, si realizohet një shfaqje teatrale;
- Gjatë muajit prill 2018, do të vazhdojnë provat për realizimin e shfaqjes së gjashtë nga subvencionet "Medea ose arti i egzilit", në menaxhimin e Alban Beqirajt;
- Në skenën për të rritur, do të realizohen 3 repriza të shfaqjeve "Ëndrra e Hamletit", "Aktori në kuti".

Qendra Kulturore e Fëmijëve:

- Zhvillimi i takimeve dhe provave të rregullta në të gjithë sektorët;
- Përfundimi i punimeve, izolimi i kulmit të sallës së korit;
- Përgatitja për pjesëmarrje të grupit të valltarëve në Festivalin në Kishnicë.

3. AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA - Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtoria juaj, duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Theksoni të arriturat e drejtorisë.

Sektori i Kulturës, Rinisë dhe Sportit:

- Shqyrtimi i kërkesave për dhënie të pëlqimeve për shfrytëzim të hapësirës;
- Realizimi i planit operativ të punës dhe angazhime të tjera sipas nevojës së DKRS- së;
- Pranimi, shqyrtimi dhe përfundimi i lëndëve ditore;
- Kontrollimi i raporteve narrative dhe financiare për projektet e subvencionuara;
- Përgatitja e tenderit për pastrimin e ish-Konsullatës austriake;
- Vazhdimi i punës së grupit punues për narrativen e qytetit të Prishtinës;
- Nënshkrimi i marrëveshjes së mirëkuptimit mes Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe organizatës "Q'ART";
- Nënshkrimi i memorandumit të mirëkuptimit për bashkëpunim të ndërsjellë mes Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Fondacioni "Trashëgimia Kulturore pa Kufij" (CHwB), në lidhje me projektet që ndërlidhen me trashëgiminë kulturore;
- Është bërë marrëveshja me "Swiss Kontakt" për mbështetje në fushën e turizmit, përfshirë ekipin e ekspertëve që do të angazhohen në asistencë të Komunes dhe DKRS-së;

- Është bërë marrëveshja me ADA Austria për financimin e një libri për artin e Kosovës;
- Eshtë iniciuar projekti me QRTK për konservimin e shtëpisë së Sali Savqit dhe Qendrës Historike të Prishtinës;
- Eshët bërë strehimi i familjeve të rrezikuara me banim në shtëpinë - Shkolla e Pare Shqipe, si dhe familjarëve u është siguruar strehim në afërsi;
- Është hapur Akademia e Animacionit në Bibliotekën “Hivzi Sulejmani”, si dhe është bërë gati thirrja për ftesë të nxënësve;
- Takimet i komisionit për ndarjen e subvencioneve në fushën e kulturës për festivale, manifestime, organizime dhe ekspozita;
- Riparime të fushave sportive dhe këndeve të lodrave në lagjet “Bregu i Diellit”, “Qafa”, “Velania” dhe në parkun “Gërmia”;
- Është bërë intervenim shtesë te fusha e sporteve dhe këndi i lodrave te Qafa, ku rrethojat janë bërë më atraktive për fëmijët me dërrasa dhe me ngjyra;
- Janë iniciuar projektet për ndërtimin e fushave të reja sportive dhe kënde të lodrave për fëmijë, si dhe janë identifikuar lokacionet për këto ndërtime.

Arkivi Komunal i Prishtinës:

- Faza e seleksionimit të njësisë org. “Banka dhe Financa”.

Biblioteka “Hivzi Sulejmani”

Veprimtaria e rregullt:

- Përpunimi fizik i materialeve bibliotekare;
- Klasifikimi dhe katalogimi i librit;
- Regjistrimi i anëtarëve të rinj;
- Huazimi i librit;
- Mirëmbajtja e ueb-faqes së bibliotekës;
- Përgatitja e raporteve mujore dhe vjetore;
- **Dita botërore e librit dhe e të drejtave të autorit (23 prill).**

Me aktivitete të larmishme, në bibliotekën “Hivzi Sulejmani” u shënuar Dita botërore e librit dhe e të drejtave të autorit.

OJQ “ETEA” prezantoi hulumtimet e lexueshmërisë së nxënësve në shkollat e mesme të Prishtinës, me ç’ rast u zhvillua një debat lidhur me këtë temë.

U shpërblyen lexuesit e dalluar të bibliotekës për vitin 2017:

- Antion Hoti, kl. VI/1, shkolla “Hasan Prishtina”;
- Arianit Preniqi, kl. XI/1, shkolla “Xhevdet Doda”.

Biblioteka u vizitua nga institucionet shkollore dhe parashkollore, me qëllim të njoftimit me fondin e librave dhe krijimit të shprehisë së leximit.

- Trajnimi dhe mbikëqyrja e tri praktikanteve në punët profesionale të veprimtarisë bibliotekare;
- Mbikëqyrja dhe angazhimi i të rinjve nga Shërbimi sprovues me punë të detyrueshme në bibliotekë (përpunimi fizik i librit).

Teatri i qytetit të Prishtinës “Dodona” - shfaqje:

- Janë realizuar 8 shfaqje të rregullta në skenën e teatrit të kukullave, çdo të shtunë, në orën 12:00 dhe 13:00.
- Janë realizuar 3 shfaqje të organizuara në skenën e teatrit të kukullave;
- Gjatë muajit prill 2018, janë realizuar reprizat e shfaqjeve “Princi i vogël”, “Kësulëkuqja”, “Mustaqoshi larosh”, “Topi Hopi”, “Goni trazovaçi”;
- Në skenën për fëmijë janë realizuar gjithsej 11 shfaqje dhe janë shikuar nga 771 shikues;
- Në kuadër të aktiviteteve promovuese, është realizuar një takim me 50 fëmijë nga Prishtina, Mitrovica dhe Ferizaj, të cilëve Valdet Rama iu ka mbajtur një ligjëratë shkollore për teatrin dhe mënyrën e realizimit të një shfaqjeje teatrale;
- Gjatë muajit prill 2018, kanë vazhduar provat për realizimin e shfaqjes së gjashtë nga subvencionet “Medea ose arti i egzilit” në menaxhimin e Alban Beqirajt;
- Në skenën për të rritur, janë realizuar 3 repriza të shfaqjeve “Ëndrra e Hamletit” dhe “Aktori në kuti”, e cila është shfaqje jubilarë në dhjetëvjetorin e realizimit të premierës;
- Janë realizuar 3 shfaqje për të rritur dhe janë shikuar nga 60 shikues;
 - Gjatë muajit prill, është realizuar një numër i madh i provave për realizimin e shfaqjeve.

Qendra Kulturore e Fëmijëve:

- Mbajtja e orëve të rregullta në të gjitha sektorët e QKF-së;
- Renovimi i kulmit të sallës së QKF-së;
- Organizimi i Aktiviteteve për Ditën e dëshmorëve:
 - përgatitja e skenarit,
 - sigurimi i sallës,
 - përgatitja dhe realizimi i programit artistik;
- Pjesëmarrja në Festivalin mbarëkombëtarë DAMASTION FOLK 2018 në Kishnicë, ku valltarët e QKF-së u shpërblyen me çmimin “Valltarët më të mirë”.

4. AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR - Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtoria juaj për muajin raportues.

Sektori i Kulturës, Rinisë dhe Sportit:

- Pranimi i 55 lëndëve për Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
- Shqyrtimi i kërkesave për dhënie të pëlqimeve për shfrytëzim të hapësirës;
- Pranimi, shqyrtimi dhe përfundimi i lëndëve ditore;
- Kontrollimi i raporteve narrative dhe financiare për projektet e subvencionuara;
- Vazhdimi i punës së grupit punues për narrativen e qytetit të Prishtinës;
- Parapërgatitjet për shpalljen e konkurs-projektimit për hartimin e projektit “Konservimi dhe adaptimi i ndërtesës së ish-Kadastrit, Prishtinë”;
- Përgatitja e konkurseve për pozitën udhëheqëse për rekrutimin e punëtorëve për Drejtorinë e Kulturës, si plotësim pozitash po ashtu edhe për institucionet vartëse të drejtorisë së Kulturës;
- Është iniciuar projekti me QRTK për konservimin e shtëpisë së Sali Savqit dhe Qendrës Historike të Prishtinës.

Biblioteka e Qytetit “Hivzi Sulejmani”:

- Vizita të rregullta të institucioneve shkollore dhe parashkollore;
- Planifikimi dhe përgatitjet për funksionalizimin e Modullit të huazimit.

Qendra Kulturore e Fëmijëve:

- Bashkëpunimin mes QKF-së dhe Institucionit për punë me rini nga Cyrihu: “Offene Jugendarbeit Zurich” (www.oja.ch);
- Përgatitje e valltarëve për pjesëmarrje në Festivalin në Rahovec.

4.1.2. Buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese

4.1.3 Takimet me palë

Arkivi Komunal i Prishtinës:

- Gjatë muajit prill kemi pranuar 60 kërkesa të palëve, të gjitha janë shqyrtuar, dhe janë njoftuar të gjitha palët për kërkesat e tyre.

5. Takimet me institucione të tjera

Sektori i Kulturës, Rinisë dhe Sportit

- Nënshkrimi i marrëveshjes së mirëkuptimit mes Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe organizatës “Q’ART”,

- Nënshkrimi i memorandumit të mirëkuptimit për bashkëpunim të ndërsjellë mes Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Fondacioni Trashëgimia Kulturore pa Kufij(CHwB),

Arkivi Komunal i Prishtinës

- Kemi pasur takime me disa institucione parashkollore dhe shkollore, të cilave u janë dhënë sugjerime të nevojshme për rregullimin e lëndës arkivore në institucionet e tyre.

6. Diskutime publike / takimet me qytetarë

- Parapërgatitjet procedurale për zhvillimin e diskutimit publik të rregullores për subvencione.

6.1.1 Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare

.

6.1.2 Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër.

7. Takime të tjera

8. SFIDAT - Nëse gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, p.sh. pengesa brenda Drejtorisë, Komunës apo institucioneve të ndryshme, ju lutem shpjegoni në këtë hapësirë.

- Numri shumë i vogël i stafit në Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Arkivi Komunal i Prishtinës

- Ftesa nga Ambasada e Kosovës në Austri, ku ishte e planifikuar që edhe Arkivi ynë të merrte pjesë në këtë ekspozitë, sepse edhe ne si institucion e kemi ndihmuar realizimin e kësaj ekspozite, por nuk kemi mundur të marrim pjesë për shkak të mos lejimit të mjeteve nga Komuna e Prishtinës, edhe pse ne kishim ftesë zyrtare.
- Problemet me vizitat e institucioneve shkollore në periferi të Prishtinës për mungesë të një veture zyrtare.

9. REKOMANDIME - Shënimi rekomandime rreth përmirësimit të mbarëvajtjes së proceseve, nëse keni, dhe nevojave të Drejtorisë për të gjitha aspektet, p.sh. trajnime të punëtorëve, furnizim me pajisje shtesë etj.

10. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES - Listoni aktivitetet e planifikuara për drejtorinë tuaj për muajin pasues:

- Shqyrtimi i kërkesave për dhënie të pëlqimeve për shfrytëzim të hapësirës;
- Realizimi i planit operativ të punës, si dhe angazhime të tjera sipas nevojës së DKRS-së;
- Pranimi, shqyrtimi dhe përfundimi i lëndëve ditore;
- Përgatitja e deklaratës së disponueshmërisë për shpalljen e konkurs-projektimit për hartimin e projektit “ Konservimi dhe adaptimi i ndërtesës së ish-kadastrit, Prishtinë”;
- Vazhdimi i punës së grupit punues për narrativën e qytetit të Prishtinës.

Arkivi Komunal i Prishtinës

- Vazhdimi i rregullimit të njësisë org. “Banka dhe Financa”.

Biblioteka “ Hivzi Sulejmani”:

- Angazhimi i një grupi të punëtorëve të bibliotekës, tri praktikanteve dhe të rinjve nga Shërbimi sprovues për futjen në katalog të librave në retrospektivë dhe përpunimi fizik i tyre, me qëllim të funksionalizimit të Modullit të huazimit sipas planifikimit, me qëllim që të fillojë brenda këtij viti;
- Përpunimi fizik i materialeve bibliotekare;
- Klasifikimi dhe katalogimi i librit;
- Regjistrimi i anëtarëve të rinj;
- Huazimi i librit;
- Mirëmbajtja e ueb-faqes së Bibliotekës;
- Përgatitja e raporteve mujore dhe vjetore;
- Mbikëqyrja dhe angazhimi i të rinjve nga Shërbimi sprovues me punë të detyrueshme në bibliotekë (përpunimi fizik i librit);
- Trajnimi dhe mbikëqyrja e tri praktikanteve në punët profesionale të veprimtarisë bibliotekare.
- Vizita të rregullta të institucioneve shkollore dhe parashkollore.

Teatri i qytetit të Prishtinës “Dodona”:

- Planifikohen shfaqje të e rregullta në skenën e teatrit të kukullave, çdo të shtunë, në orën 12:00 dhe 13:00;
- Planifikohen shfaqje të organizuara në skenën e Teatrit të Kukullave;
- Gjatë muajit maj 2018, planifikohet realizimi i shfaqjes premierë nga subvencionet për vitin 2017, “Medea ose arti i egzilit” në menaxhimin e Alban Beqirajt;
- Planifikohet realizimi i reprizave të shfaqjes “Medea ose arti i egzilit”;
- Premiera pritet të realizohet më 9 maj;
- Sipas lejeve të lëshuara nga DKRS, do të realizohen aktivitete si në vijim:
Qendra “Artpolice”, prova në sallën B, nga data 30 prill deri me 25 maj 2018;
- Do të realizohet programi me rastin e ditës së shkollës “Zenel Hajdini”;
- Planifikohet realizimi i aktiviteteve të rregullta për këtë pjesë të sezonit, “Festa e abetares”, sipas kërkesave të institucioneve shkollë, aktivitete të IP-kopshteve private;
- Planifikohen aktivitete përkitazi me realizimin e Festivalit tradicional ndërkombëtar të teatrove të kukullave, i cili mbahet në javën e katërt të muajit shtator.

Qendra Kulturore e Fëmijëve:

- Përgatitjet dhe realizimi i punëtorisë nga Klubi i Ambasadorëve të Rinj, me temën “Vullnetarizmi”, në kuadër të festës së 9 majit - Ditës së Evropës;
- Rregullimi i ndriçimit të brendshëm në zyrat e QKF së;
- Pjesëmarrje në Festivalin në Rahovec- grupi i valltarëve.

11. TË TJERA - Shënimi çështjet tjera që mendoni se janë me rëndësi të raportohen e që nuk kanë qenë të përfshira në pikat e mësipërme.

Qendra Kulturore e Fëmijëve:

- Përpilimi i planit buxhetor për të gjitha aktivitetet kulturore për vitin 2018 si dhe plani buxhetor për Festivalin “Ylberi i Prishtinës”.

